



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:057127
Datë: 25.04.2024
Numri i dokumentit: 05621807

A-REV.nr.8/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Nebojša Boričić dhe Rrustem Thaqi anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësve L.L , E.L dhe E.L nga ..., K. D., kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale—Divizioni për Ndihmë Sociale me seli në P., me bazë juridike anulim i aktit administrativ të organit të paditur, duke vendosur sipas revizionit të paraqitur nga paditësit, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.487/2023, të datës 06.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 25 Prill 2024, merr:

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë si i palejuar revizioni, i parashtruar nga paditësit, L.L, E.L., dhe E L., kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.487/2023, të datës 06.03.2024.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, A nr. 684/21, të datës, 29.03.2023, **Refuzohet** kërkesë padia e paditësve, L.L. , E..L. dhe E. L, me të cilën kanë kërkuar anulimin e Vendimit të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Divizioni për Ndihmë Sociale, me nr.3956, i datës 18.01.2021, dhe të detyrohet e paditura që paditësve tu njihet e drejta në ndihmë sociale , sipas masës 15, të Pakos Emergjente, për muajin Prill, Maj dhe Qershor, **si e pa bazuar.**

Duke vendosur në procedurë ankimore sipas ankesës së paditësit, kundër aktgjykimit si më lartë të shkallës së parë, Gjykata e Apelit-Departamenti për Çështje Administrative me aktgjykimin, AA.nr.487/2023 të datës 06.03.2024, të kontestuar me revizion , e refuzon si të pa bazuar ankesën e paditësve, L.L , E.L dhe E. L, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, A nr. 684/2021, i datës, 29.03.2023, vërtetohet.

Kundër aktgjykimit si më lartë të Gjykatës së Apelit, paditësit në Gjykatë Supreme parashtrojnë revizion, me të cilin e kontestojnë ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të; shkeljeve esenciale të

dispozitive të Procedurës Kontestimore dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës pas analizës së kërkesës për revizion të merr aktvendim me të cilin miratohet si i bazuar revizioni i paditësve , prishet aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit AA nr. 487/2023 dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative A nr. 684/2021, dhe lënda i kthehet në rigjykim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme shqyrtoi revizionin e ushtruar në pajtim me nenin 52.1, të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe gjen se:

Revizioni i paraqitur është i palejuar.

Sipas Nenit 24, të Ligjit për Konfliktet Administrative, (LKA), parashihet se, *kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtrijë në Gjykatë Supreme, kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor. Kërkesa mund të parashtrihet vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale, ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishin ndikim në zgjidhjen e çështjes.*

Sipas Nenit 25 të LKA, parashihet se, *kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës, prokurori publik mund t'i parashtrijë Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, nëse me vendim të tillë është shkelur ligji, dispozitat e tjera ose akti i përgjithshëm.*

Sipas nenit 50, parag.1, të LKA, parashihet ,” *kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor i dërgohet gjykatës brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit kundër të cilit pala paraqet kërkesën. Sipas parag.2, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë paraqitet brenda nëntëdhjetë (90), ditëve nga dita kur u është dërguar palëve vendimi, kundër të cilit paraqitet kërkesa”.*

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe dispozitive të cituara të Ligjit për Konflikte Administrative kjo gjykatë gjen se, kundër vendimeve të formës së prerë për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtrijë në Gjykatë Supreme, kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ndërsa Prokurori Publik, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë. Nga theksimet si më lartë rezulton se, me revizion nuk mund të kontestohen vendimet e formës së prerë të Departamentit për Çështje Administrative të gjykatës së shkallës së dytë, prandaj kjo gjykatë e hedhë poshtë revizionin e paditësve si të palejuar.

Nga parashtrimet si më lartë dhe në kuptim të nenit 52.1, lidhur me nenin 24 dhe 25, të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME- PRISHTINË
A. REV. nr. 8/2024, datë 25 Prill 2024

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani